



# SCORPION SECURITY

KOMPANIA E SIGURIMIT / SECURITY COMPANY

SINCE  
**2004**

Nr.Unik : 810680092, Tel : +383 (44) 257740 / +383 (45) 278840, E-mail : sigurimi.scorpion@gmail.com  
Adresa: Rr.VËLLEZËRIT GËRVALLA, NR. 70 000, FERIZAJ, REPUBLIKA E KOSOVËS

## Faktet dhe Argumentet për LOT 1

Të nderuar,

Në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-042 për Prokurim Publik në Republikën e Kosovës, parashtrijmë këtë Ankesë pranë juve si OSHP, me rastin e Njoftimit B58 mbi Vendimin e AK-Kuvendi Komunal Lipjan për LOT 1 të datës 18.06.2026, si dhe Vendimit të datës 26.06.2026 për refuzimin e Kërkesës sonë për Rishqyrtim.

**Në këtë aktivitet të prokurimit me titull: Llot 1 Sigurimi fizik i objekteve të institucioneve komunale, ndërtesat e Administratës, Qendra për Punë Sociale, Arkivit të Qytetit, dhe Zona Ekonomike ne Qylagë, Llot 2 Sigurimi fizik i objekteve në shkollat SHFMU Vëllezërit Frashëri, Gjumnazi Ulpiana, dhe SHMP Adem Gllavica Lipjan. dhe me Nr.613-26-670-2-1-1, Komisioni Vlerësues i Autoritetit Kontraktues ka rënë në kundërshtim me Dispozitat e LPP-së dhe Rregullores Nr.001/2022 i plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr.002/2024, si:**

1. Neni 1 “Qëllimi”,
2. Neni 7 “Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi”
3. Neni 59 “Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve”,
4. Neni 60 “Kriteret për Dhënien e Kontratës”
5. Neni 61 “Tenderët Jo-Normalisht të ulët”
6. Neni 17.32 “Dosja e Tenderit” i Rregullores Nr.001/2022
7. Neni 32 “Pushimi Vjetor” i Ligjit Nr.03/L-212

### Pretendimi 1:

Ne si OE , konsiderojme se AK, ka rënë ndesh me **Nenin 1** të LPP-së sepse duke iu referuar këtij neni, qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efektive, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla, ashtu sic citohet edhe në ligj.

Poashtu, konsiderojmë se AK-Kuvendi Komunal Lipjan, nuk ka vepruar **konform nenit 7, paragrafi 1 të Ligjit Nr.04/L-042**, citim:

1. *Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.*

### Pretendimi 2:

Vendimi i AK-së për shpalljen fitues për LOT 1 të GOE:**MEB L.L.C & KSF MAJOR SH.A**, është në kundërshtim edhe me **Nenin 59**, pika 4 – citim:

*“Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.*

Pra, ky nen flet për Ekzaminimin, Vlerësimin dhe Krahasimin e Tenderëve dhe Autoriteti Kontraktues me datë 18.06.2026, ka shpallur fitues për LOT1 një GOE i cili në realitet është ofertë e papërgjegjshme dhe duhet eliminuar sipas Nenit 61 si tender apo ofertë jo-normalisht e ulët.

Tani do të shpjegojmë në mënyrë të detajuar pretendimet tona, duke kalkuluar cmimin e ofertës së GOE së rekomanduar për kontratë dhe do krahasojmë me ofertën tonë të përgjegjshme, të përmbushur dhe plotësuar sipas Kërkesave dhe Kriteve të Autoritetit Kontraktues në përputhje të plotë me Ligjin Nr.04/L-042:

Pas ofrimit të qasjes në dokumente nga AK në përputhje me Nenin 10, pika 3 e LPP-së, në lidhje me ofertën e GOE: MEB L.L.C & KSF MAJOR SH.A, ne si OE kemi vërejtur se oferta e GOE së rekomanduar për kontratë, **nuk është** në përputhje me kërkesat e Autoritetit Kontraktues – Kuvendi Komunal Lipjan e që bie në kundërshtim me Nenin 59, paragrafi 4 i cituar më lartë.

Në dosjen e Tenderit, tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2, paraqesim Kërkesën Nr.2 në lidhje me kalkulimin e analizës financiare:

<p><b>Kërkesa 2 – Operatori Ekonomik duhet të prezantojë një Deklaratë se do të paguajë pagën bazë për punëtorë 500.00€ bruto. Deklaratës duhet ti bashkangjitet Analiza Financiare me të gjitha llogaritjet, sipas dëshmise.</b></p>	<p><b>Dëshmi 2- Të dëshmohet me një Deklaratë dhe Analizë Financiare të vulosur dhe të nënshkruar. Analiza financiare duhet të përfshijë Pagën bazë për Punëtorë 500.00€ bruto,+ Pushimet vjetore + Kontributet Pensionale 5%, Punëdhënës), Fitimi i Kompanisë, TVSH 18% dhe në fund Totali i Ofertës. Analiza financiare e kalkulimeve të pagës së punëtorit duhet të llogaritet me radhë sipas pozicioneve të lartëpërmendura në mënyrë që kalkulimet totale të rezultojnë të sakta.</b></p>
---	--

Ne konstatojmë se GOE i rekomanduar për kontratë nuk ka kalkuluar saktë dhe drejtë sipas kërkesës Nr.2 të dosjes së tenderit, në vijim do paraqesim kalkulimet sipas analizës financiare të GOE MEB L.L.C & KSF.MAJOR SH.A:

- Paga totale Bruto për një punëtorë = **500.00€**
- Pushimi vjetor = **24.50€**
- 5% kontributi i Punëdhënësit = **25.00€**
- Totali paga + Pushimi vjetor = **549.50€**
- Shpenzimet operative mujore + fitimi = **0.10€**
- Totali Paga + Shpenzimet operative = **549.60€**
- TVSH = **98.93€**
- Totali Cmimi me TVSH për 1 muaj = **648.53€**

**648.53€ x 17 Punëtorë = 11,025.01€ x 24 muaj = 264,600.24€**

Poashtu ky Goe, nuk ka paraqitur cmimin e njejtë total edhe në Tabelën "Përshkrimi i Cmimeve" (**264,614.40€**) me arsyetimet se "ky dallim rezulton si pasojë e mënyrës së përlllogaritjes nga ana e Autoritetit Kontraktues, pra që nuk përshtaten cmimi njësi/ orë pa tvsh dhe me tvsh, e poashtu edhe cmimi mujor me tvsh dhe pa tvsh dhe totali per 24 muaj".

**Nga analiza financiare e paraqitur nga GOE: MEB L.L.C & KSF MAJOR SH.A., rezulton se për pozicionin "Pushimi Vjetor" është paraqitur vlera prej vetëm 24.50€** në muaj për secilin punëtor. Një kalkulim i tillë nuk është në përputhje me kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe nuk pasqyron koston reale të detyrimit ligjor që punëdhënësi ka ndaj punëtorit gjatë shfrytëzimit të pushimit vjetor.

Duke pasur parasysh se paga bruto e kërkuar nga Autoriteti Kontraktues është 500.00 €, kostoja mujore e pushimit vjetor duhet të shpërndahet proporcionalisht në 12 muajt e vitit, respektivisht duhet të kalkulohet sipas Nenit 32 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, citim : Paragrafi 1. "I punësuar gjatë çdo viti kalendarik ka të drejtë për pushim vjetor të paguar në një kohëzgjatje prej së paku katër (4) javë, pavarësisht a punon me orar të plotë apo të shkurtuar".

**Kalkulimi i saktë i vlerës mujore të pushimit vjetor duhet bërë kështu:**

**160 orë** pune sipas Nenit 20 të Ligjit të Punës x **3.00€** cmimi i orës së pagës 500.00 € sipas vendimit Nr.10/273 të qeverisë së Republikës së Kosovës = **480.00€** + Kontributi i Punëdhënësit 25.00€ = **505.00€ /12 muaj = 42.08 € në muaj.**

Pra, cdo OE i cili kalkulon ndryshe pozicionin e pushimit vjetor nga kalkulimi i mësipërm, rezulton të ketë ofertë të pasaktë nga kërkesa Nr.2 e DT-së, sepse kosto mujore e pushimit vjetor duhet të përmbajë edhe koston e kontributit të punëdhënësit e cila kalkulohet shtesë mbi pagën Bruto.

**Meqjithatë, GOE ka paraqitur vlerën E PASAKTË prej vetëm 24.50 €, e cila në nivel vjetor rezulton të jetë 294.00 € (24.50 € x 12 muaj = 294.00 €).**

Kjo do të thotë se sipas kalkulimit të vetë GOE-së, kostoja vjetore e pagës bruto për muajin e pushimit vjetor mbulohet vetëm në vlerën prej 294.00 €, respektivisht 276.96 € neto, e jo në vlerën e kërkuar prej 500.00 € bruto, siç është përcaktuar nga Autoriteti Kontraktues.

Si rezultat, çmimi total i ofertuar nga GOE është ndikuar drejtpërdrejt nga ky kalkulim i pasaktë i pushimit vjetor, duke krijuar një avantazh të padrejtë konkurrues ndaj operatorëve të tjerë ekonomikë, e në vecanti ndaj nesh si OE(SCORPION GROUP SH.P.K) që kemi kalkuluar saktë kostot reale të të gjitha pozicioneve në analizën financiare sipas kërkesave në Dosjen e Tenderit.

**Tani do paraqesim një kalkulim shabllon të saktë të kalkulimit të analizës financiare sipas Kërkesës Nr.2 në DT me fitim 0.00€:**

	Kalkulimi për 1 dhe 17 punëtorë	Vlera	Periudha
1	Paga 500.00€ Bruto	500.00 €	Muaj
2	Pushimi vjetor mesatar në muaj, katër javë = 20 ditë pune (160 orë x 3.00€=480.00€ + Kontributi i Punëdhënësit 25.00€ = 505.00€ / 12 muaj)	42.08€	Muaj
3	Kontributi i Punëdhënësit 5%	25.00 €	Muaj
4	Gjithsej paga bruto + Pushimi Vjetor + Kontributi i Punëdhënësit(1+2+3)	567.08 €	Muaj
5	Gjithsej kosto mujore për 17 punëtor (567.08€ x 17 punëtorë)	9,640.36 €	Muaj
6	Totali i pagave të 17 punëtorëve për 24 muaj (9,640.36€ x 24 muaj)	231,368.64 €	24 Muaj
7	Fitimi i Kompanisë	0.00€	24 Muaj
8	TVSH totale 18% (231,368.64€ x 18% TVSH) =	41,646.35	24 Muaj
9	Pagat totale per 24 muaj me TVSH	273,014.99	24 Muaj

**Pra, sic e shihni nga tabela e kalkulimeve të mësipërme, cmimi minimal me 0.00€ fitim është 273,014.99€ dhe cdo ofertë e cila është nën pragun e kësaj shume, rezulton të jetë ofertë e papërgjegjshme sipas Nenit 61 të LPP-së.**

**Ndërsa, oferta jonë(SCORPION GROUP) e përgjegjshme është 273,043.20€.**

Në këto rrethana, Autoriteti Kontraktues do të duhej që ta anulonte vendimin B58 për LOT 1 dhe lëndën ta kthej në rivlerësim dhe pastaj ofertën e GOE ta eliminojë sipas Nenit 61 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me ofertën me çmim jo normalisht të ulët, pasi analiza financiare e GOE-së, demonstroi se nuk është përfshirë në mënyrë korrekte të gjitha kostot e detyrueshme që rrjedhin nga kërkesat në DT dhe marrëdhënia e punës e cila reflekton në realizimin e kontratës, e poashtu **ky pretendim gjen mbeshtetje edhe në Rregulloren Nr.001/2022, përkatësisht neni 17.32 "Në rast se çmimi i ofruar nga Ofertuesi nuk mbulon pagat minimale të punonjësve që do të përfshihen në ekzekutimin e kontratës, e rregulluar nga Ministritë në sektorë të ndryshëm, oferta mund të konsiderohet si ofertë jo-normalisht e ulët".**

**Sepse, sipas logjikës së kalkulimit të GOE-së, kostoja e paraparë për pushimin vjetor mbulon vetëm 294.00 € bruto në vit, gjë që nuk korrespondon me pagën bruto prej 500.00 € të kërkuar nga Autoriteti Kontraktues dhe nuk pasqyron koston reale të këtij detyrimi ligjor.**

Për më tepër, gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të ofertës së GOE: MEB L.L.C & KSF MAJOR SH.A., kemi konstatuar se i njëjti ka paraqitur një deklaratë në të cilën shprehimisht deklaron se gjatë realizimit të kontratës do të respektojë Ligjin e Punës në fuqi, Ligjin për Shërbimet Private të Sigurisë si dhe Vendimin Nr. 10/273 lidhur me pagën minimale. Megjithatë, nga analiza financiare e dorëzuar nga GOE, nuk rezulton se janë kalkuluar dhe përfshirë të gjitha detyrimet financiare që burojnë nga legjislacioni i punës sic ka deklaruar vet GOE, përkatësisht shtesat ligjore për punën gjatë natës, punën gjatë ditëve të festave zyrtare, punën gjatë vikendeve dhe të drejtat e tjera që rrjedhin nga Ligji i Punës.

**Për më tepër, pozicioni i vetëm i paraqitur për pushimin vjetor rezulton i kalkuluar në mënyrë të pasaktë dhe nën vlerën reale ligjore.**

Prandaj, ekziston një mospërputhje evidente ndërmjet deklaramit të Operatorit Ekonomik se do të respektojë legjislacionin në fuqi dhe përmbajtjes së analizës financiare të ofertës së tij, e cila nuk demonstroi se të gjitha këto obligime ligjore janë përfshirë në strukturën e ofertës të paraqitur në analizën financiare.

Për më tepër, oferta e OE SCORPION GROUP SH.P.K., në vlerë prej **273,043.20€**, është përpiluar në përputhje të plotë me Kërkesën Nr. 2 të Dosjes së Tenderit dhe përmban një analizë financiare të detajuar, të saktë dhe të qëndrueshme ekonomikisht. Vlera e ofertës sonë përputhet plotësisht (100%) me vlerën e paraqitur në Tabelën "Përshkrimi i Çmimeve" dhe Formularin e Tenderit.

Gjithashtu, në analizën tonë financiare janë përfshirë dhe kalkuluar saktë të gjitha kostot e kërkuara nga Autoriteti Kontraktues, përfshirë edhe koston e pushimit vjetor, e cila është llogaritur në përputhje me pagën bruto të kërkuar në Dosjen e Tenderit dhe reflekton koston reale të një page të plotë të punëtorit gjatë periudhës së shfrytëzimit të pushimit vjetor.

Për verifikim të mëtejshëm të këtyre pretendimeve, ju referohemi analizës tonë të saktë financiare të paraqitur në formën screenshot:

<b>Kalkulimi për 1&amp;17 punëtorë</b>		Vlera	Periudha
Përshkrimi i aktivitetit/obligimeve			
1	Paga për orë të dites (500.00€ Bruto)	500.00 €	Muaj
2	Pushimi vjetor mesatar në muaj, katër javë - 20 ditë pune (160 orë x 3.00€=480.00€ + Kontributi i Punëdhënësit 25.00€ = 505.00€ / 12 muaj)	42.08€	Muaj
3	Kontributi i Punëdhënësit 5%	25.00 €	Muaj
4	Gjithsej paga bruto + Pushimi Vjetor + Kontributi i Punëdhënësit(1+2+3)	567.08 €	Muaj
5	Gjithsej kosto mujore për 17 punëtor (567.08€ x 17 punëtorë)	9,640.36 €	Muaj
6	Totali i pagave të 17 punëtorëve për 24 muaj (9,640.36€ x 24 muaj)	231,368.64 €	24 Muaj
Fondi i orëve është 176 për një muaj sipas Udhëzimit Administrativ të MPMS			

		TOTALI- 24 MUAJ
<b>PAGAT TOTALE BRUTO PËR 17 PUNËTORË ME OBLIGIMET SHITESË</b>		<b>231,368.64 €</b>
<b>FITIMI I KOMPANISË</b>		<b>23.90 €</b>
<b>TVSH 18%</b>		<b>41,650.66 €</b>
<b>TOTALI I PËRGJITHSHËM ME TVSH</b>		<b>273,043.20 €</b>
<b>Totali Mujor me TVSH</b>		<b>11,376.80 €</b>

Duke pasur parasysh se analiza jonë financiare është përpiluar në përputhje të plotë sipas Kërkesës Nr.2 në Dosjes së Tenderit, duke përfshirë kostot e detyrueshme ligjore dhe kontraktuale për realizimin e kontratës, vlera prej 273,043.20€ përfaqëson koston reale minimale për ofrimin e shërbimeve sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktues.

Gjithashtu, ne deklarojmë se Autoriteti Kontraktues, në vendimin mbi Refuzimin e kërkesës tonë për rishqyrtim të dt 26.06.2026, nuk ka dhënë arsytim të plotë, konkret dhe të individualizuar për secilin pretendim të ngritur nga ne si OE, e sidomos AK ka qenë i manget në arsyetimin e dhënë në pretendimin tonë kryesor të dytin(2), në lidhje me gabimin e GOE në Analizën e tyre Financiare, i cili gabim do ta shpallte si ofertë të papërgjegjshme. Përgjigjja e dhënë e AK-së ishte e përgjithshme, duke paraqitur vetëm Analizën Financiare të GOE-së dhe nuk përmbante analizë faktike të pretendimeve tona, duke vepruar në kundërshtim me nenin 62.2 të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik, i cili obligon Autoritetin Kontraktues që vendimi mbi refuzimin të jetë i arsyetuar. Mungesa e një arsyeimi efektiv i pamundëson OE-së të kuptojë bazën ligjore dhe faktike të refuzimit dhe cenon të drejtën për një mjet juridik efektiv

**Ne si OE konstatojmë se çdo ofertë me vlerë më të ulët se oferta jonë(273,043.20€) duhet të shpallet ofertë e papërgjegjshme sipas Nenit 61 të Ligjit për Prokurimin Publik dhe Nenit 17.32 i rregullores Nr.001/2022.**

### **Pretendimi 3:**

Duke u nisur nga dëshmitë e lartcekura, vijmë në përfundim se AK ka rënë ndesh edhe me **Nenin 60** të LPP-së, kjo për arsye se ne si OE kemi përfillur të gjitha kriteret e dhëna në dosjen e tenderit, si dhe me nenin 60 par.1 pika 1.1 të Ligjit Nr.04/L-042 citim:

1. Autoriteti kontraktues do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar ose:

1.1 tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët;

Pra, ky nen parasheh shpalljen e ofertës sonë fituese e cila është në përputhje të plotë me Ligjin për Prokurim Publik dhe kriteret e paraqitura në DT.

**Përfundim:** Për shkak të kalkulimit të pasaktë të kostos së pushimit vjetor nga GOE: MEB L.L.C & KSF MAJOR SH.A dhe ndikimit të drejtpërdrejtë që ky element ka pasur në uljen e çmimit total të ofertës, ne si OE në kërkesën për Rishqyrtim kemi kërkuar nga AK, që të anulojë vendimin B58 për LOT1 të datës 18.06.2026 dhe të eliminojë ofertën e papërgjegjshme të GOE-së së rekomanduar dhe të na shpërblejë me kontratë ne OE "SCORPION GROUP SH.P.K.", si operatori ekonomik që ka paraqitur ofertën e përgjegjshme me çmimin më të ulët, sepse sic shpjeguam më lartë me kalkulime financiare, se cdo ofertë tjetër me vlerë më të ulët se oferta jonë prej 273,043.20€ është ofertë e papërgjegjshme dhe poashtu, cdo ofertë tjetër e shpallur fitues me cmim më të shtrenjtë se oferta jonë, **konsiderohet shkelje e nenit 6, paragrafi 1 i LPP-së – Ekonomiciteti dhe Efikasiteti, citim:**

1. *Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.*

Anadaj, duke u bazuar në Nenin 108/A të LPP-së dhe bazuar në të gjitha provat e bashkangjitura, kërkojmë nga OSHP te merret:

- V E N D I M
- APROVOHET, si e bazuar ankesa jonë, dhe lenda të kthehet ne,
- RIVLERSIM, ku gjate rivleresimit, të SHPERBLEHEMI me kontrate ne si OE i pergjegjshem me cmimin me te lire në përputhje të plotë me Ligjin Nr.04/L-042.

  
  
JETMIR EMËRLLAHU  
Menaxher  
"SCORPION SECURITY"



Data: 06.07.2026